REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE

Programi:**Bachelor**

Drejtimi: **Histori**

Lënda: Histori e Kulturës Shqiptare (shek.XIV-XIX)

Pedagogu:	Prof. dr. Fatmira Rama
Ngarkesa:	4 ETCS (15 javë: 2 leksione dhe 1 seminar në javë)
Lloji i lëndës:	me zgjedhje
Viti/semestri:	II/I

Përshkrimi: Është disiplinë, që synon të njohë studentët me njohuri të kulturës qytetare shqiptare që nga fillimet e Mesjetës, deri në prag të Shpalljes së Pavarësisë së vendit . Ajo synon të paraqesë aspekte themelore të kulturës qytetare në rrafshin urbanistik e arkitekturor, zhvillimet arsimore, letrare, të arteve figurative dhe muzikore, të evidentojë disa figura të shquara, duke vënë në pah pikat e takimit me kulturën e vendeve ballkanike.

Temat e leksioneve:

Leks. 1. Kultura në qytetet shqiptare në antikitetin e vonë dhe fillimet e mesjetës (shek.IV-VI). Urbanistika në qytetet shqiptare si: Durrësi, Berati, Butrinti, Lezha, etj. Ndikimi bizantin dhe rindërtimi i kështjellave të vjetra dhe ndërtimi i fortifikimeve të reja përballë sulmeve barbare.
Leks. 2. Disa tipare të kulturës mesjetare gjatë periudhës bizantine (shek. 7-14); ikonografia bizantine në territoret shqiptare dhe rryma e arteve figurative të Apollonisë. Arti muzikor kishtar dhe Jan Kukuzeli, muzikant i shquar i periudhës bizantine.
Leks. 3. Arsimi në periudhën e Perandorisë Otomane në territoret shqiptare: shkollat fetare dhe laike në gjuhën turke-arabe në shek. XVI-XIX. Rrjeti i shkollave në gjuhët greke, latino-italiane dhe ato sllave.
Leks. 4. Dëshmitë e para të gjuhës dhe shkrimit shqip: Meshari i Gjon Buzukut, vepra e parë e plotë e shkruar në gjuhën shqipe dhe shkrimtarët e tjerë të hershëm të veriut (shek.XVI-XVIII).
Leks. 5. Shkollat dhe kurset e para të mësimit të gjuhës shqipe pranë kishave dhe manastireve katolike dhe ortodokse.
Leks. 6. Fenomeni "Voskopojë" në kulturën shqiptare (shek. XVIII). Shtypshkronja e Voskopojës e para në Ballkan. Akademia e Voskopojës dhe rrezatimi i saj në territoret shqiptare në Gadishullin e Ballkanit. Kishat e Voskopojës dhe lulëzimi i ikonografisë.
Leks. 7. Veçori të qyteteve shqiptare në periudhën e Perandorisë Osmane: arti i ndërtimit të kishave, manastireve, xhamive dhe teqeve. Ndikimi i urbanistikës dhe i artit osman.
Leks. 8. Ikonografia në shek. XVI-XIX. Shkolla e Onufrit (shek.XVI), kodikët shqiptarë (shek.VI-shekulli XIX). Ikonografë të njohur të shekujve XVII-XIX.
Leks. 9. Rryma letrare e bejtexhinjve dhe shkrimi i gjuhës shqipe me germa arabe, shek.XVIII. Disa protagonistë të shquar të saj.
Leks. 10. Qytetet shqiptare gjatë Rilindjes Kombëtare dhe elementët e reja perëndimorë.
Leks. 11. Ndikimi i kulturës arbëreshe në atë shqiptare. Jeronim de Rada dhe organet e para të shtypit në gjuhën shqipe.
Leks. 12. Publicistika dhe letërsia shqiptare gjatë Rilindjes Kombëtare. Gazetat, revistat dhe librat e botuar në diasporë dhe depërtimi i tyre ilegal në Shqipëri.

Leks. 13. Përpjekjet për zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe dhe shkolla e parë laike dhe kombëtare e Korçës (7 mars 1887). Përhapja e shkollave dhe e kurseve të gjuhës shqipe në Shqipëri dhe përballja me politikën shtypëse osmane.
Leks. 14. Kongresi i Manastirit (nëntor 1908) dhe përcaktimi i alfabetit unik shqiptar. Kongresi i Elbasanit (1909) dhe Shkolla Normale e Elbasanit.
Leks. 15. Artet figurative dhe lëvrimi i muzikës qytetare gjatë Rilindjes Kombëtare. Kolë Idromeno – artist multidimensional i kulturës shqiptare në këtë periudhë. Krijimi i bandave të para muzikore me karakter laik në Shqipëri.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- *Detyrim frekuentimi në*:70% të seminareve	
- *Angazhimi në seminare:*	10% e notës
- *Testi I:* në javën e 6-të	10% e notës
- *Testi II*:në javën e 10-të	10% e notës
- *Detyra e kursitose ese*:rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- *Kontrolli përfundimtar:* provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

1.K.Frashëri, *Historia e qytetërimit shqiptar*, Tiranë: Akademia e Shkencave, 2008.
2. R.Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë- Prishtinë, Pejë-Dukagjini, 1997.

Literatura plotësuese:

1. Neritan Ceka, *Ilirët*, Tiranë: Migjeni, 2005
2. Hysi Myzyri, *Shkollat e para shqipe*, Tiranë, 2000
3. Eqerem Çabej, *Shqipja në kapërcyell. Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, Tiranë: Çabej, 2006.
4. *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, Vëll.I, Tiranë: MASH, 2003
5. *Historia e artit shqiptar*, Vëll.I, Tiranë: Instituti i Lartë i Arteve, 1990.
6. *Historia e muzikës shqiptare*, vëll.I, Tiranë, Instituti i Lartë i Arteve, 1990
7. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.I, II, Tiranë, Toena, 2002
8. Viktori Puzanova, *Mbi artin bizantin dhe postbizantin shqiptar*, Tiranë, 55, 2005.